



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 2048

NR. VENDIMI 908

VENDIM

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë nga :

Gjyqtar : ERVIN POLLOZHANI

asistuar nga sekretare gjyqesore Lusjana Fezollari, sot më datë 16. 02. 2021, mori në shqyrtim në seancë gjyqesore publike, çështjes civile me Nr. 1173/3626/2048 Regj. Themeltar që i përket :

**PADITES:** SHOQERIA «\*\*\*», shoqeri e themeluar sipas ligjeve te Mbreterise se Bashkuar, me seli ne \*\*\*, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim perfaqesimi dt. \*\*\* nga av. \*\*\* dhe av. \*\*\*.

**IPADITUR:** SHOQERIA “\*\*\*\*” shpk me seli ne \*\*\*, me NIPT \*\*\*, e perfaqesuar ne gjykim me autorizimin e perfaqesimit dt. \*\*\* nga av. \*\*\* (ne mungese).

**OBJEKTI:** 1. Pushimi i cënimit të të drejtave të pronësisë industriale të shoqërisë “\*\*\*\*” që rrjedhin nga zotërimi i markës së regjistruar dhe të mirënjohur “\*\*\*\*”;

2. Ndalimi i të Paditurit që të përdorë markën tregtare \*\*\* dhe çdo shenjë tjetër të ngjashme me të, gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare, pa autorizimin e shoqërisë “\*\*\*\*”, duke përfshirë këtu edhe ndalimin e të Paditurit për të përdorur markën për qëllime marketingu, reklamimi ose publiciteti;

3. Ndalimi i të Paditurit të ofrojë shërbime duke përdorur markën \*\*\* dhe çdo shenjë tjetër të ngjashme me të;

4. Ndalimi i veprimeve të konkurrencës së pandershme nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe mospërsëritja e veprimeve të tilla në të ardhmen;

5. Publikimi i vendimit përfundimtar të gjykatës në median publike me shpenzimet e të Paditurit;

6. Detyrimi i të Paditurit të paguajë të gjithë shpenzimet gjyqësore duke përfshirë edhe pagesat e kryera nga paditësi për shërbimet juridike, siç do të bëhen.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 106, 154, 154/a, 156, 348 te K. Pr. Civile. Nenet 638, 639 te K. Civil. Nenet 156, 184, 184/a, 184/b, 184/c, 187 te ligjit Nr. 9947 dt. 07. 07. 2008 « Per pronesine industriale », i ndryshuar. Neni 6bis i Konventes se Parisit per Mbrojtjen e Pronesise Industriale.

Gjykata, pasi administroi provat shkresore, degjoi pretendimet përfundimtare të perfaqesuesit të pales paditese, i cili kërkoi: Pranimin e kerkese padise sipas objektit të saj, perfaqesuesin e pales se paditur qe ne seancen gjyqësore qe mori pjese kerkoi: Rrezimin e kerkese-padise si te pa bazuar ne prova dhe ne ligj, pasi e shqyrtoi çështjen ne teresi, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor,

**VEREN :**

Se, paditësi shoqëria « \*\*\* » shoqëri e se drejtes tregtare britanike, i është drejtuar nepermjet perfaqesuesit të saj kesaj gjykate, me kërkesë-padine me objektin e sipercituar.

Ne referim të Nenit 185 të K.Pr.Civile pala paditese ka pakesuar objektin e kerkese-padise sa me siper citohet ne pjesen hyrese te vendimit, pare ne raport me objektin formal te kerkese-padise, ne kushtet kur nje pjese e kerkimeve te objektit te saj u plotesuan si te tilla gjate gjykimit nga pala e paditur.

Pas kalimit të ketij moment procedural, fillimisht, gjykata shqyrtoi juridiksionin e kesaj çështjeje te paraqitur per gjykim dhe bazuar ne Nenet 36, 59 te K. Pr. Civile, konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil.

Lidhur me kompetencën lëndore, në bazë të Nenit 41 të K. Pr. Civile : ”Në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë janë të gjitha mosmarrëveshjet civile e

mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të tjera”. Meqënëse ndodhemi përpara një mosmarrëveshjeje me karakter tregtar që rrjedh nga marrëdhënia juridiko – tregtare e pronësive mbi markat, gjykata referuar dhe Neneve 334-335 të K. Pr. Civile çmon se është kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Lidhur me kompetencën tokësore në bazë të Nenit 43 të K. Pr. Civile, “Kur i padituri është person juridik paditë ngrihen në gjykatën e vendit ku i padituri ka qendren e tij...”. Nga ana tjetër neni 348 i K. Pr. Civile përcakton se : «Mosmarrëveshjet që rrjedhin nga patentat, markat tregtare dhe të shërbimit, dizenet tregtare, modelet dhe çdo e drejtë tjetër që rrjedh nga pronësia industriale, gjykohen nga seksioni i mosmarrëveshjeve tregtare në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod”.

Sa me sipër, kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane për shqyrtimin e kësaj çështjeje objekt konflikti.

Pala paditese, bazuar në Nenin 32/a të K. Pr. Civile legjitimohet t’i drejtohet gjykates me kete kerkese-padi ne baze te se ciles do te perfitoje te drejta personale - pasurore.

Gjithashtu gjykata, në vështrim të Neneve 71, 72 dhe 73 të K. Pr. Civile, çmoi se nuk ekzistojnë për të, shkaqe papajtueshmërie, ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pa kundërshtuar dhe nga palet prezent në gjykim.

Në bazë të nenit 35 të K. Pr. Civile gjykimi u zhvillua nga një gjyqtar.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi e provuar se :

Shoqëria “\*\*\*\*” (në vijim referuar edhe si “Paditësi” ose “\*\*\*\*”) është një shoqëri tregtare mjaft e njohur dhe me famë botërore për projektimin, prodhimin, shitjen dhe tregtimin e automjeteve \*\*\* dhe \*\*\*, si dhe është njëkohësisht pronare e markave tregtare të mirënjohura \*\*\*, \*\*\* dhe \*\*\*.

Në këtë kontekst, marka \*\*\* (idem, marka \*\*\* dhe \*\*\*) është një markë mjaft e njohur nga konsumatorët/publiku në shkallë ndërkombëtare dhe kombëtare, në një nivel të tillë sa që ka fituar statusin e markës së mirënjohur në kuptim të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” (i ndryshuar) (në vijim referuar edhe si “Ligji 9947”).

Krahas sa më sipër, Paditësi, në vijim të ushtrimit të aktivitetit të tij tregtar, ka regjistruar markën tregtare \*\*\* në shumë vende kudo në botë, duke përfshirë këtu edhe Republikën e Shqipërisë. Më konkretisht, shoqëria “\*\*\*\*” ka aplikuar dhe regjistruar në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me ligjin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (në vijim referuar edhe si “DPPI”) markën tregtare \*\*\* me të dhënat e mëposhtme:

|                               |             |
|-------------------------------|-------------|
| Marka tregtare                | ***         |
| Përfaqësimi i markës tregtare |             |
| Numri i regjistrimit          | ***         |
| Data e depozitimit            | ***         |
| Data e regjistrimit           | ***         |
| Data e mbarimit të mbrojtjes  | ***         |
| Statusi                       | Regjistruar |

Lista e mallrave dhe/ose shërbimeve      Klasa 12: Mjete motorike, dhe pjesë dhe aksesore të tyre; aparate për zhvendosje përmes tokës, ajrit ose ujit.

Klasa 35: Reklamim/publicitet; marketing; modelim për reklamim ose promovim të shitjeve; organizimi i ekspozitave për qëllime tregtare ose reklamuese; administrim tregtar i liqensimit të mallrave dhe shërbimeve të tjerëve; informim dhe këshillim tregtar për konsumatorët [dyqani i këshillimit të konsumatorëve]; menaxhim biznesi; administrim biznesi; funksione zyre.

Krahas markës së mirënjohur \*\*\*, shoqëria “\*\*\*\*” ka aplikuar dhe regjistruar pranë DPPI-së edhe markën tjetër të ngjashme dhe po aq të mirënjohur: \*\*\*.

|                               |             |
|-------------------------------|-------------|
| Marka tregtare                | ***         |
| Përfaqësimi i markës tregtare | *** (fjalë) |
| Numri i regjistrimit          | ***         |

Data e depozitimit \*\*\*

Data e regjistrimit \*\*\*

Data e mbarimit të mbrojtjes \*\*\*

Statusi Regjistruar

**Lista e mallrave dhe/ose shërbimeve      Klasa 07: Aparate dhe instrumente shkencorë, lundrimi, studimore, fotografike, kinematografike, optike, peshe, matjeje, sinjalizimi, kontrolli (mbikqyrjeje), të shpëtimit të jetës dhe mësimdhënieje; aparate dhe instrumenta për përcjelljen, ndërrimin, transformimin, akumulimin, rregullimin ose kontrollin e elektricitetit; aparate për regjistrimin, transmetimin ose riprodhimin e zërit ose imazheve; mbajtës magnetikë të të dhënave, disqe regjistruese; disqe kompakti, DVD dhe media regjistruese dixhitale tëtjera; mekanizma për aparatet që operohen me monedha; arka, makina llogaritëse, pajisje të përpunimit të të dhënave, kompjutera; software kompjuterike; aparate për fikjen e zjarrit; makineri automatike të shitjeve dhe mekanizma për aparatet që operohen me monedha; makina llogaritëse, pajisje të përpunimit të të dhënave dhe kompjutera;aparate dhe instrumentepa tel (wireless); hardware, firmware ose software kompjuterike; kufje për kompjutera ose për pajisje audio, audiovizuale ose tëtelekomunikimit; Asistentë personalë Dixhitalë; makineri që operohen me monedha dhe që luajnë muzikë të përzgjedhur nga regjistrime të ndryshme (jukeboxes); pajisje multimediale; aparate dhe pajisje MP3 ose MP4; regjistrues MP3 ose MP4; hard disqe (drajvera) të lëvizshëm; drajvera universale Serial Bus; mause për kompjutera; mbështetëse për mause; lojra kompjuterike; pajisje për lojra kompjuterike që përshtaten për tu përdorur me marrësit e TV; panele komandimi (konsolle) për lojra elektronike [që përshtaten për tu përdorur me marrës televiziv]; kamera; kameraweb-i (Webcams); disqe kompakti, lexues disqesh kompakti; DVD, lexues DVD-sh; disqe për ruajtjen e medias dixhitale; regjistrues optik; media optike; informacion i siguruar në formë elektronike; aparate për regjistrimin, transmetimin ose riprodhimin e informacionit në formëelektronike; muzikë dixhitale; libra dixhitalë (tableta); publikime elektronike; telefonë; telefonë të lëvizshëm; kufje dhe aksesore për telefonë të lëvizshëm; instalime të telefonit për makinë; pajisje të riprodhimit të zërit; sisteme të pajisjeve elektronike të sofistikuara për paraqitjen e imazheve dhe zërit në shtëpi me cilësi të teatrit (home theatre); mikrofonë; televizorë; radio; pajisje të telekomunikimit; aparate dhe pajisje për transmetimin e pandërprerë (streaming) audio, video dhe të të dhënave; aparate dhe instrumente shkencorë; pajisje të alarmit anti-vjedhje; panele dhe grumbullime instrumentesh; lente për llamba; sensorë temperature; aparate testimi; llogaritës; lexues kasetash; kasete me shirit; media regjistruese; projektorë; Sisteme Globale Pozicionimi, Sisteme Satelitore Lundrimi; pajisje të alarmit për emergjencë në autostradë; kompase; lente kontakti, syze dhe syzedielli; veshje mbrojtëse.**

**Klasa 12: Automjete; aparate për lëvizje nga toka, uji dhe/ose ajri; automjete për terren tokësor; pjesë dhe aksesore për automjete dhe automjete për terren tokësor; automjete me motor, pjesët dhe aksesoret e tyre; bicikleta, karroca për fëmijë (strollers), karroca për bebe (prams) dhe pjesët e aksesoret e tyre.**

**Klasa 37: Ndërtim ndërtesash; riparim; shërbime instalimi; mirëmbajtje, riparim, shërbim, rregullim, restaurim, inspektim, përkujdesje, pastrim, lyerje dhe ilustrim për mjetet tokësore me motor dhe pjesët e aksesoret e këtyre mallrave; shërbime diagnostikuese ose inspektimi, të gjitha për makina me motor ose për pjesët dhe aksesoret e tyre, ose për motorët me djegie të brendshme; shërbime këshillimi në lidhje me mirëmbajtjen, riparimin, shërbimin, rregullimin, restaurimin, inspektimin, kujdesin, pastrimin, lyerjen dhe ilustrimin e automjeteve dhe pjesët e aksesoret e tyre; instalimi i aksesoreve për automjetet tokësore me motor; shërbime informimi dhe këshillimi në lidhje me të gjitha sa më sipër.**

**Marka \*\*\* gëzon edhe statusin e markës së mirënjohur në kuptim të ligjit 9947 dhe Konventës së Parisit “Për mbrojtjen e Pronësisë Industriale” si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit dhe reklamimit të saj tek publiku i sektorit përkatës. Si rrjedhojë, marka \*\*\* përmbush të gjithë kriteret ligjore të përcaktuara në mënyrë të detajuar në “Rekomandimin e Përbashkët për Mbrojtjen e Markave të Mirënjohura, të Asamblesë së Unionit të Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe Asamblesë së Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale” dhe VKM-në nr. 315, datë 31.05.2018 “Për miratimin e rregullores për markat” mbi markat e mirënjohura:**

**shkalla e njohjes apo njohja e markës tregtare në sektorin publik përkatës;**

**kohëzgjatja, shtrirja dhe hapësira gjeografike në të cilën përdoret marka tregtare;**

**kohëzgjatja, shtrirja dhe hapësira gjeografike e çdo promovimi të markës tregtare, duke përfshirë reklamën ose publicitetet dhe prezantimet, në panairë apo ekspozita, të mallrave dhe/ose shërbimeve për të cilën marka është aplikuar;**

**kohëzgjatja dhe hapësira gjeografike e çdo regjistrimi dhe/ose e çdo aplikimi për regjistrim të markës, në masën që ato pasqyrojnë përdorimin ose njohjen e markës;**

**të dhënat e zbatimit të suksesshëm të të drejtave të lidhura me markën tregtare dhe në veçanti, shkalla në të cilën marka është njohur si e mirënjohur nga autoritetet përgjegjëse;**

**vlera e lidhur me markën tregtare.**

Keshtu, sipas pales paditese, (i) Marka \*\*\* është mjaft e njohur në tregun shqiptar të automjeteve. Mund të thuhet me siguri se kjo markë është mjaft e njohura tek sektori i publikut përkatës, i cili përbëhet në përgjithësi nga dealer-at dhe distributorët e autorizuar, shitësit dhe blerësit e automjeteve \*\*\*. Madje, vetë i Padituri bën pjesë në publikun përkatës që i njohin mjaft mirë markën \*\*\*.

(ii) Marka \*\*\* ka një periudhë mjaft të gjatë kohe që përdoret dhe njihet nga publiku në mbarë botën. Kjo markë është shtrirë në shumë vende rreth botës, dhe është posaçërisht e mirënjohur në rajone si: Evropa, Amerika e Veriut, Azia etj.

Volumi i shitjeve të automjeteve tregon shtrirjen e gjerë gjeografike dhe zonat gjeografike ku përdoret e njihet kjo markë, duke e bërë atë në mënyrë të padiskutueshme një markë të mirënjohur.

(iii) Përsa i përket promovimit të markës \*\*\*, Paditësi investon shuma të konsiderueshme çdo vit për organizimin e panairove dhe salloneve të makinave luksoze duke qenë se marka \*\*\* është një nga markat më të njohura të automjeteve të kategorisë \*\*\*.

Paditësi ka prodhuar automjete autentike \*\*\* që prej vitit 1948, automjete që janë shitur dhe vazhdojnë të shiten në mënyrë tejet të suksesshme në 180 tregje botërore.

(iv) Pavarësisht për sa më sipër, Paditësi gëzon të gjithë të drejtat ligjore që rrjedhin nga zotërimi i markës tregtare kombëtare \*\*\* me numër regjistrimi \*\*\*.

Bazuar në statusin e markës së regjistruar, si dhe në përputhje me nenin 156 (të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi i markës tregtare) të ligjit 9947, Paditësi gëzon të drejtën ekskluzive të përdorimit të markës \*\*\*, së bashku me emrin dhe logon përkatëse, duke ndaluar njëherazi personat e tretë që të përdorin këtë markë në mënyrë të paautorizuar. Në këtë drejtim, ligji 9947 i jep të drejtën pronarit të markës së regjistruar që jo vetëm të ndalojë përdorimin e shenjave të tjera identike me markën e tij, por edhe ndalimin e përdorimit të çdo shenje tjetër të ngjashme me të, siç është për shembull \*\*\* (markë tjetër e regjistruar nga paditësi për më tepër).

Në vijim të disa hetimeve të kryera në treg nga Paditësi, si dhe bazuar në një verifikim të posaçëm të kryer pranë ambienteve tregtare të “\*\*\*\*” sh.p.k. (në vijim referuar edhe si “I Padituri”) me vendodhje në autostradën \*\*\*, ka rezultuar fillimisht se:

Në fasadën e godinës ku i Padituri ushtron aktivitetin e tij tregtar, ishte

**vendosur një tabelë që mbante në mënyrë të paautorizuar markën tregtare \*\*\*, e demonstruar si më poshtë:**

**Në hyrje të godinës ishte vendosur një tabelë/poster që mbante në mënyrë të paautorizuar markën tregtare \*\*\*, e demonstruar si më poshtë:**

**Gjithashtu, i Padituri përdorte në mënyrë të paautorizuar markën tregtare \*\*\* si vulë/stampë në blloqet e servisit/shërbimit të tij të automjeteve, e demonstruar si më poshtë:**

Të gjithë veprimet e sipërpërmendura përbënin shkelje flagrante të të drejtave të pronësisë industriale të Paditësit dhe vinin haptazi në kundërshtim me të drejtat e shoqërisë “\*\*\*\*” si pronar i markës tregtare \*\*\*.

Nisur nga sa më sipër, shoqëria “\*\*\*\*” i është drejtuar të Paditurit fillimisht nëpërmjet një letre paralajmëruese, duke kërkuar pushimin e menjëhershëm të shkeljeve të të drejtave të markës tregtare \*\*\*.

Në mungesë të një përgjigjeje dhe reagimi nga ana e të Paditurit, shoqëria “\*\*\*\*” ka vendosur më pas t’i drejtohet gjykatës me kërkesë-padinë përkatëse objekt gjykimi.

Në vijim të paraqitjes së kërkesë-padisë, i Padituri konfirmoi në prapësimet e tij me shkrim (shih deklaratën e mbrojtjes) dhe gjatë seancave përgatitore të zhvilluara se ai ka marrë masa të menjëhershme për ndërperjen e situatës së paligjshmërisë. Sikundër u parashtrua nga i Padituri, shoqëria “\*\*\*\*” shpk kishte pasur probleme të administrimit që kishin sjellë si pasojë mosmarrjen në konsideratë të kërkesave legjitime të paditësit.

Për këtë arsye, në vijim të nxjerrjes së urdhrit të brendshëm nga Administratori i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. më datë 07.10.2019, pala e paditur plotësoi pjesërisht kërkesat e përcaktuara në objektin fillestar të padisë. Megjithatë, pavarësisht këtij fakti, gjatë një investigimi të rastësishëm të kryer nga ana e paditësit më datë 17.01.2020 (tre ditë përpara zhvillimit të seancës gjyqësore të planifikuar më datë 20.01.2020), ka rezultuar se shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. kishte ndërmarrë veprime të tjera të reja në drejtim të shkeljes së të drejtave të pronësisë industriale të paditësit dhe realizimit të veprimeve të mëtejshme të konkurrencës së pandershme:

Në fasadën e godinës ku i Padituri ushtron aktivitetin e tij tregtar, ishte hequr tabela që mbante në mënyrë të paautorizuar markën tregtare \*\*\* dhe ishte rivendosur një tjetër tabelë, siç demonstron më poshtë:

Në hyrje të godinës, ishte hequr tabela/posteri që mbante në mënyrë të paautorizuar markën tregtare \*\*\* dhe ishte rivendosur një tjetër tabelë/poster identik në pjesën e sipërme të godinës, siç demonstron më poshtë:

Veprimet e mësipërme demonstroi qartësisht faktin se i Padituri, duke qenë tashmë plotësisht i ndërgjegjshëm mbi situatën e paligjshmërisë së veprimeve të tij, ka vijuar të veprojë me keqbesim duke shkelur sërish të drejtat e pronësisë industriale të Paditësit dhe rregullat e konkurrencës së ndershme.

Paditësi, një shoqëri ndërkombëtare me reputacion të lartë kudo në botë, vendosi sërish t’i



japë kohë dhe të lejojë shoqërinë “\*\*\*\*” shpk që të ndërpresë veprimtarinë e përsëritur në kundërshtim me ligjin duke i kërkuar kësaj të fundit që të mos përdorë absolutisht markën \*\*\* apo çdo shenje tjetër të ngjashme me të.

Në seancën gjyqësore të datës 18. 02. 2020, pala e paditur konfirmoi heqjen e reklamave/tabelave nga fasada e biznesit të tij. Për këtë arsye, si dhe në vijim të kërkesës së paditësit për të kryer verifikimet përkatëse, gjykata vendosi të shtyjë seancën gjyqësore për në datë 20.03.2020.

Seanca gjyqësore e datës 20.03.2020 nuk u zhvillua si pasojë e gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shpalluar me aktet ligjore të njëpasnjëshme të Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit.

Gjatë kësaj periudhe kohe relativisht jo të shkurtër, paditësi ka konstatuar se shoqëria “\*\*\*\*” shpk ka hequr vetëm pjesën ballore/të përparme të reklamave dhe tabelave të reja të vendosura në fasadën e biznesit të saj (pjesa e pasme e reklamave/tabelave nuk është hequr dhe ekziston mundësia e rivendosjes së tyre në të ardhmen), por fatkeqësisht ka vazhduar ende që të shkelë të drejtat e markave tregtare dhe shenjave dalluese të shoqërisë “\*\*\*\*”.

Më konkretisht, pala e paditur ka vazhduar të përdorë në mënyrë të kundërligjshme markën “\*\*\*\*” të paditësit duke ofruar shërbimet e saj online përmes mediave sociale.

Kështu, nga një verifikim online i kryer nga vet pala paditëse, ka rezultuar se shoqëria “\*\*\*\*” ka krijuar dhe/ose vazhdon të përdorë në mënyrë të paautorizuar markën “\*\*\*\*” duke vazhduar të përcjellë tek konsumatorët idenë se i padituri ka lidhje me/ose është përfaqësues i Paditësit në Shqipëri:

Facebook: Faqa “\*\*\*\* \*\* Albania”:

[https://www.facebook.com/pages/category/Automotive-Dealership/\\*\\*\\*\\*-\\*\\*\\*\\*-\\*\\*\\*\\*-Albania\\*\\*\\*\\*/](https://www.facebook.com/pages/category/Automotive-Dealership/****-****-****-Albania****/)

Instagram: Faqa “\*\*\*\*” [https://www.instagram.com\\*\\*\\*\\*](https://www.instagram.com****).

Në këto rrethana, si dhe duke konsideruar natyrën dhe karakterin përsëritës të shkeljeve ligjore dhe veprimeve të tilla me keqbesim të palës së paditur, siç dëshmojnë provat e paraqitura në gjykim dhe kronologjia e veprimeve të kundërligjshme të ndjekura në mënyrë përsëritëse nga i padituri, pala paditëse shprehu se ajo nuk mund të ketë asnjë garanci ligjore apo siguri juridike se të drejtat e tij nuk do të shkelen sërish në të ardhmen apo se i padituri nuk do të përdorë në mënyrë të paautorizuar markën “\*\*\*\*” në forma të tjera, duke përfshirë këtu mundësinë e rivendosjes së tabelave në vendet e mëparshme për aq kohë sa këto tabela/reklama nuk janë hequr plotësisht dhe rivendosja e tyre është lehtësisht e realizueshme.

Për këtë arsye, shoqëria “\*\*\*\*” duke iu drejtuar me këtë kërkesë-padi Gjykatës nëpërmjet vendimit të saj kerkonte që të rivendoste në vend të drejtat dhe interesat e shkelura. Kjo pasiqe, pavarësisht përpjekjeve të gjykatës dhe mundësive të palës paditëse për zgjidhjen e çështjes-objekt gjykimi, pala e paditur ka vijuar të ndërmarrë në mënyrë të përsëritur veprime të kundërligjshme që vazhdojnë të shkelin të drejtat e paditësit dhe përbëjnë veprime të konkurrencës së pandershme.

Në seancën gjyqësore të datës 24.09.2020, Paditësi depozitoi kërkesën për pakësim të objektit të padisë duke hequr ato kërkesa të plotësuara nga i Padituri në lidhje me tabelat dhe shenjat e reklamuar në fasadën e biznesit të tij. Në të njëjtën kohë, Paditësi paraqiti pranë gjykatës provat që vërtetnin shkeljen e të drejtave të tij nëpërmjet ofrimit të shërbimeve online nga i Padituri me person kontakti \*\*\*.

Emri i faqeve (\*\*\*\* \*\* Albania), adresa e biznesit në këto rrjete sociale, pamjet fotografike të

ngarkuara në faqe (pamje të godinës/fasadës së vjetër të biznesit me tabelat që përmbajnë markën \*\*\*), domain-i i përdorur tek personi i kontaktit (i njëjti domain i regjistruar në QKB nga i padituri) dhe vetë konfirmimi në seancë gjyqësore i përfaqësuesit të palës së paditur për administrimin e faqes nga një ish-punonjës i shoqërisë, përbëjnë qartazi një pohim dhe dëshmi të pakundërshtueshme mbi vazhdimësinë e veprimeve të paligjshme të shoqërisë “\*\*\*\*”.

Ofrimi i shërbimeve online nëpërmjet përdorimit në mënyrë të paautorizuar të emrit, logos dhe markës \*\*\* përbën në mënyrë flagrante një cënim të të drejtave të pronësisë industriale të \*\*\* dhe është njëherazi një veprim tjetër i rëndë i konkurrencës së pandershme.

Në të njëjtën seancë gjyqësore (datë 24.09.2020), i Padituri paraqiti përpara gjykatës disa prova të reja me qëllim demonstrimin e pushimit të cënimit të të drejtave të Paditësit në ambientet e tij të biznesit. Në një kohë kur Paditësi vazhdoi të kërkojë ndalimin e veprimeve të paligjshme të të Paditurit dhe mbylljen e faqeve që ofrojnë shërbime nën markën \*\*\*, është konstatuar nga pala paditese në mënyrë krejtësisht surprizuese se pala e paditur ka ndërmarrë veprime të tjera flagrante në shkelje të ligjit dhe në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në objektin e padisë.

Në vijim të shqyrtimit të provave të paraqitura nga i Padituri në seancë gjyqësore, evidentohet se tabela që ka mbajtur në mënyrë të paautorizuar markën tregtare \*\*\* në hyrje të godinës së tij të biznesit, mban tashmë të shkruar me gërma kapitale: \*\*\*.

Në kundërshtim me parashikimet ligjore e sipërpërmendura, i Padituri pra ka vazhduar të përdorë shenjën “\*\*\*\*” duke shkelur në këtë mënyrë të drejtat e pronësisë industriale të shoqërisë “\*\*\*\*”.

Siç u tha më sipër, Paditësi jo vetëm që është pronar i markës së regjistruar dhe të mirënjohur \*\*\*, por ligji 9947/2008 dhe neni 638 i Kodit Civil i jep të drejtë pronarit të një marke (në rastin tonë, marka \*\*\*) që të ndalojë përdorimin e një shenje identike apo të ngjashme me markën e tij, ashtu si dhe të ndalojë kryerjen e veprimeve të konkurrencës së pandershme duke përdorur shenjat dalluese të një subjekti tjetër.

Për më tepër, marka “\*\*\*\*” është e regjistruar rregullisht në emër të paditësit pranë DPPI-së (shih ekstrakti me të dhënat e markave tregtare).

Per te gjitha keto fakte te sipercituara pala paditese perfundimisht pas konstatimit te paqendrueshmerise ne sjelljen e pales se paditur me veprime dhe mosveprime te qellimshme qe cenonin te drejtat e pronesise industriale te pales paditese, kerkoi qe ceshtja te zgjidhej perfundimisht nga gjykata duke u pranuar tashme objekti i padise se saj.

#### Arsyetimi i gjykates.

Nga ana e saj gjykata referuar objektit dhe bazes ligjore te kerkese-padise si dhe përpos shpjegimeve të palëve ndërgjyqëse çmon se referuar Nenit 6 të K. Pr. Civile percaktohet se: “Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet”. Nga ana tjetër Neni 16/1 përcakton se “Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dipsozitat ligjore..... Gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës. Në Nenin 28 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: “Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrohen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm.”. Në kuptim të këtyre dispozitave gjykata në ushtrimin e veprimtarisë së saj, udhëhiqet gjithnjë nga ligji, nuk e paragjykon çështjen objekt gjykimi dhe u krijon palëve të gjitha hapësirat ligjore për të realizuar një proces të drejtë gjyqësor. Cilësimi juridik i fakteve

bëhet në përputhje me cilësimin ligjorë të tyre.

Nisur nga keto percaktime procedurale, gjykata ne analize te pretendimeve dhe prasimeve te paleve ndergjyqese dhe provave te administruara ne gjykim çmon se kerkese-padia duhet pranuar si e tille per arsyet e meposhtme:

Në nenin 140 i Ligjit Nr. 9947 dt. 07.07.2008 “Per pronesine Industriale” percakton se:

“Një markë mund të jetë çdo shenjë, në veçanti fjalët, duke përfshirë emrat personalë ose disenjimet, shkronjat, numrat, ngjyrat, formën e mallrave ose të paketimeve të tyre ose tingujt, me kusht që këto shenja të jenë të afta: a) të dallojnë mallrat apo shërbimet e një personi fizik apo juridik nga ato të një personi tjetër fizik apo juridik; b) të përfaqësohen në regjistër në mënyrë të tillë, që të mundësojnë autoritetet kompetente dhe publikun të percaktojnë qartë dhe saktë objektin e mbrojtjes që i njihet pronarit të saj”.

Neni 141 i ligjit percakton se: “Një shenjë ka karakter dallues, nëse nëpërmjet saj përdoruesi i zakonshëm dallon një numër mallrash dhe shërbimesh specifike, nga një tjetër numër mallrash dhe shërbimesh, të njëjta me të parat, e lidhur, përkatësisht, me origjinën tregtare të tyre. 2. Karakteri dallues i një shenje vlerësohet në lidhje të ngushtë me mallrat dhe shërbimet, të cilat shenja ka për qëllim t’i dallojë”.

Neni 143 i Ligjit percakton se: “1. Marka nuk mund të mbrohet nëse përdorimi i saj bie në kundërshtim me të drejtat e mëparshme.

2. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo duhet të deklarohet e pavlefshme kur:

a) është e njëjtë me një markë të mëparshme dhe mallrat e shërbimet, për të cilat është aplikuar ose regjistruar ajo, janë identike me mallrat ose shërbimet, për të cilat është mbrojtur marka e mëparshme;

b) është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të mëparshme, e cila mbrohet për mallra apo shërbime identike ose të ngjashme dhe kur, për shkak të njëjlojshmërisë ose të ngjashmërisë, ekziston mundësia e shkaktimit të konfuzionit te publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes me markën e mëparshme;

c) është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të mëparshme, edhe kur është për t’u regjistruar ose është regjistruar për mallra apo shërbime, që nuk janë të ngjashme me ato, për të cilat është regjistruar marka e mëparshme, kur marka e mëparshme ka një reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe përdorimi ose regjistrimi i markës në fjalë, pa shkak të arsyeshem, fiton prioritet të padrejtë ose dëmton natyrën dalluese apo emrin e mirë të markës së mëparshme.

3. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo deklarohet e pavlefshme, nëse cenon të drejtat e mëparshme, të fituara, si:

a) të drejtën e emrit tregtar, me kusht që ky emër ose pjesa thelbësore e tij të jetë e njëjtë apo e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet, dhe që pronari i emrit tregtar të prodhojë apo të sigurojë përkatësisht mallra ose shërbime, të njëjta ose të ngjashme me ato të markës, që kërkohet të regjistrohet;

b) të drejtën e një personi, emri, mbiemri ose pamja e jashtme e të cilit është e njëjtë ose e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet;

c) të drejtat e pronësisë industriale, përfshirë emrat e varieteteve të mbrojtura, bimore dhe/ose shtazore dhe të treguesve gjeografikë;

ç) të drejtat e autorit të një vepre ose të një pjese të saj, me kusht që ajo të jetë e njëjtë ose e ngjashme me markën, që kërkohet të mbrohet.

4. Marka nuk mbrohet, nëse është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të regjistruar, për mallra apo shërbime të njëjta ose të ngjashme dhe nëse vlefshmëria e saj ka mbaruar për shkak të mbarimit të afatit të mbrojtjes, për një periudhë gjashtëmujore nga mbarimi i këtij afati.

5. Markë e mëparshme, në kuptim të pikës 2 të këtij neni, vlerësohet:

- a) marka, me një datë aplikimi për regjistrim më të hershme sesa data e aplikimit për regjistrim e një marke tjetër tregtare, duke pasur parasysh, kur është rasti, pretendimin për prioritet për atë markë, sipas nenit 147 të këtij ligji;
- b) marka, që është regjistruar më parë, nëpërmjet një marrëveshjeje ndërkombëtare, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë;
- c) aplikimi për një markë, sipas përcaktimit të shkronjave “a” e “b” të kësaj pike, në varësi të regjistrimit të tyre;
- ç) marka, e cila, në datën e aplikimit për regjistrim, ose në datën e prioritetit, në rastet kur pretendohet për prioritet, është e mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, të publiku i sektorit përkatës, si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit ose reklamimit, në përputhje me parashikimet e DPPM-së dhe të autoriteteve ndërkombëtare.”

Neni 156 i Ligjit PI, paragrafi 2, parashikon: ....“Pronari i markës së regjistruar gëzon të drejtën të ndalojë personat e tretë të përdorin, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare, pa autorizimin e tij: a) një shenjë, që është e njëjtë me markën, për mallra dhe shërbime, që janë të njëjta me ato, për të cilat është regjistruar marka; b) një shenjë, që është e njëjtë ose e ngjashme me markën apo që, për shkak të njëllojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve, për të cilat përdoret shenja, me mallrat apo shërbimet, që mbulohen nga marka e regjistruar, mund të shkaktojnë konfuzion të publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes së shenjës me markën tregtare; c) një shenjë të njëjtë ose të ngjashme për mallra apo shërbime, edhe kur këto nuk janë as të njëjta e as identike me ato, për të cilat është regjistruar marka, në rast se marka ka reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe nga përdorimi i shenjës, pa shkak të arsyeshem, realizohet një përfitim i padrejtë ose dëmtohet natyra dalluese apo emri i mirë i markës”.

Neni 184/2 i ligjit përcakton se: “Përbën shkelje të së drejtës, sipas rastit, çdo përdorim, kufizim, imitim ose bashkëshoqërim i paautorizuar i disenjës së regjistruar, markës apo treguesit gjeografik, si dhe çdo veprim tjetër që cenon të drejtat e pronarit, sipas neneve 127, 156 dhe 178, të këtij ligji. I njëjti rregull zbatohet edhe për disenjon, markën apo treguesin gjeografik të depozituar në DPPM, për të cilin është bërë kërkesë për regjistrim, sipas këtij ligji.”

Në lidhje me sa u parashtrua më sipër, për zgjidhjen e drejtë të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, gjykata çmon se është e nevojshme të zgjidhen çështjet juridike si vijon:

A janë markat tregtare “\*\*\*”, “\*\*\*” marka të mirënjohura në Shqipëri ?

A jemi përpara konkurrencës së pandershme për shkak të produkteve të tregtuara nga palet ndërgjyqese ?

Sa i përket çështjes së parë të shtruar për zgjidhje në arsyetimin e këtij vendimi, gjykata vlerëson se kushti ligjor i mbrojtjes së markës tregtare, krahas kritereve të tjera ligjore është dhe mirënjohja e saj në vendin ku përdoret si e tillë. Neni 143 pika 5, germa “ç” e ligjit përcakton se: “Marka, e cila, në datën e aplikimit për regjistrim, ose në datën e prioritetit, në rastet kur pretendohet për prioritet, është e mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, të publiku i sektorit përkatës, si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit ose reklamimit, në përputhje me parashikimet e DPPM-së dhe të autoriteteve ndërkombëtare.

“Markat e mirënjohura” mbrohen nëpërmjet zbatimit të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale (1883) e ndryshuar, (Konventa e Parisit) dhe Neni 16 i Marrëveshjes mbi Aspektet Tregtare të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (TRIPs). Qëllimi i Nenit 6bis të

Konventës së Parisit është të mbrojtë markat tregtare të mirënjohura. Vendet e saj anëtare i nënshtrohen detyrimit të refuzojnë ose anulojnë regjistrimin e markave tregtare të cilat janë konfuze apo të ngjashme me një markë të mirënjohur, apo/dhe të ndalojnë përdorimin e tyre. Parakusht për mbrojtjen e një marke të mirënjohur është ngjashmëria e produktit. Megjithatë, mbrojtja shtrihet përtej ngjashmërisë së produktit, kur përdorimi i markës tregtare do të shfaqte një lidhje midis produkteve dhe pronarit të markës tregtare të mirënjohur, e cila ndoshta do të shkaktonte dëm pronarit të markës tregtare.

Kriteret ligjore të percaktuara me siper pare në raport me Konventën që ti japin një marke statusin “marke e mirënjohur” kërkojnë nga gjykata që vlerësimin e tyre ta bëjë në përputhje me kuptimin dhe qëllimin që kanë në vetvete këto terma të përdorura në ligj për raport me rrethanat konkrete. Kështu koncepti “përdorim” nënkupton për gjykatën se pari përdorimin e saj minimalisht në një grup të caktuar të interesuarish dhe maksimalisht për publikun e gjere dhe se dyti kohezgjatja e këtij përdorimi përben kriter tjetër vlerësues për gjykatën për dhenien e këtij statusi. Koncepti i “reklamimit ose publikimi” lidhet me evidentimin e kësaj marke nepermjet formave të ndryshme të të bërit publike si reklama, spote publicitare, postera, flete-palosje etj. U provua gjyqesisht se kjo marke tregtare është e mirënjohur në tregun shqiptar për sa kohë që ajo si e tillë është tregtuar për një kohë shumë të gjatë dhe vazhdon ende.

Po kështu u provua për gjykatën se marka \*\*\* gëzon statusin e markës së mirënjohur në kuptim të ligjit 9947 dhe Konventës së Parisit “Për mbrojtjen e Pronësisë Industriale” si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit dhe reklamimit të saj tek publiku i sektorit përkatës. Si rrjedhojë, marka \*\*\* përmbush të gjithë kriteret ligjore të percaktuara në mënyrë të detajuar në “Rekomandimin e Përbashkët për Mbrojtjen e Markave të Mirënjohura, të Asamblesë së Unionit të Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe Asamblesë së Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale” dhe VKM-në nr. 315, datë 31.05.2018 “Për miratimin e rregullores për markat” mbi markat e mirënjohura:

shkalla e njohjes apo njohja e markës tregtare në sektorin publik përkatës;  
kohëzgjatja, shtrirja dhe hapësira gjeografike në të cilën përdoret marka tregtare;  
kohëzgjatja, shtrirja dhe hapësira gjeografike e çdo promovimi të markës tregtare, duke përfshirë reklamat ose publicitetet dhe prezantimet, në panairë apo ekspozita, të mallrave dhe/ose shërbimeve për të cilën marka është aplikuar;  
kohëzgjatja dhe hapësira gjeografike e çdo regjistrimi dhe/ose e çdo aplikimi për regjistrim të markës, në masën që ato pasqyrojnë përdorimin ose njohjen e markës;  
të dhënat e zbatimit të suksesshëm të të drejtave të lidhura me markën tregtare dhe në veçanti, shkalla në të cilën marka është njohur si e mirënjohur nga autoritetet përgjegjëse;  
vlera e lidhur me markën tregtare.

Kështu, (i) Marka \*\*\* është mjaft e njohur në tregun shqiptar të automjeteve. Mund të thuhet me siguri se kjo markë është mjaft e njohur tek sektori i publikut përkatës, i cili përbëhet në përgjithësi nga dealer-at dhe distributorët e autorizuar, shitësit dhe blerësit e automjeteve \*\*\*. Madje, vetë i Padituri bën pjesë në publikun përkatës që i njohin mjaft mirë markën \*\*\*.

(ii) Marka \*\*\* ka një periudhë mjaft të gjatë kohe që përdoret dhe njihet nga publiku në mbarë botën. Kjo markë është shtrirë në shumë vende rreth botës, dhe është posaçërisht e mirënjohur në rajone si: Evropa, Amerika e Veriut, Azia etj.

Volumi i shitjeve të automjeteve tregon shtrirjen e gjerë gjeografike dhe zonat gjeografike ku përdoret e njihet kjo markë, duke e bërë atë në mënyrë të padiskutueshme një markë të mirënjohur.

(iii) Përsa i përket promovimit të markës \*\*\* , pala paditëse investon shuma të

konsiderueshme çdo vit për organizimin e panairove dhe salloneve të makinave luksoze duke qenë se marka \*\*\* është një nga markat më të njohura të automjeteve të kategorisë \*\*\*.

(iv) Pavarësisht për sa më sipër, Paditësi gëzon të gjithë të drejtat ligjore që rrjedhin nga zotërimi i markës tregtare kombëtare \*\*\* me numër regjistrimi \*\*\*.

Në lidhje me pretendimin e konkurrencës së pandershme, pavarësisht se konkurrenca e pandershme nuk është trajtuar në mënyrë të gjerë dhe ezauruese në legjislacionin Shqiptar, Kodi Civil ka përcaktuar elementet për të garantuar mbrojtjen ligjore të shënjavave dalluese dhe të drejtave të patentës, dhe në nenin 638 parashikon se, “veprimet e konkurrencës së pandershme kryhen prej cilitdo që: (i) përdor emrat ose shënjat dalluese të cilat mund të sjellin ngatërresë me emrat dhe shënjat dalluese të përdorura ligjërisht nga të tjerë, ose imiton produktet e një konkurrenti ose kryen veprime të cilat mund të sjellin ngatërresa me produktet dhe veprimtarinë e një konkurrenti; (ii) trajton si të vetat cilësitë e produkteve ose të ndërmarrjes së konkurrentit; (iii) përdor vetë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi çdo mjet tjetër që nuk përputhet me parimet e ndershmërisë profesionale dhe mund të dëmtojë veprimtarinë e tjetrit”.

Për më tepër, neni 639 parashikon se: “Vendimi që vërteton veprime të konkurrencës së pandershme ndalon vazhdimin e tyre dhe përcakton masat e nevojshme me qëllim që të zhduken pasojat. Në qoftë se këto veprime janë kryer me faj, personi që i ka kryer detyrohet të shpërblejë dëmin”.

Në bazë të nenit 156 të Ligjit 9947, pronari i një marke tregtare gëzon të drejtën ekskluzive të përdorimit të markës, si dhe njëherazi, ai gëzon të drejtën të ndalojë personat e tretë që të përdorin, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare, pa autorizimin e tij:

një shenjë, që është e njëjtë me markën, për mallra dhe shërbime, që janë të njëjta me ato, për të cilat është regjistruar marka - neni 156 (2)(a);  
një shenjë, që është e njëjtë ose e ngjashme me markën apo që, për shkak të njëjlojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve, për të cilat përdoret shenja, me mallrat apo shërbimet, që mbulohen nga marka e regjistruar, mund të shkaktojnë konfuzion të publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes së shenjës me markën tregtare - neni 156 (2)(b);  
një shenjë të njëjtë ose të ngjashme për mallra apo shërbime, edhe kur këto nuk janë as të njëjta e as identike me ato, për të cilat është regjistruar marka, në rast se marka ka reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe nga përdorimi i shenjës, pa shkak të arsyeshem, realizohet një përfitim i padrejtë ose dëmtohet natyra dalluese apo emri i mirë i markës – neni 156 (2) (c).

Në përputhje me sa më sipër, ndalohet gjithashtu: a) vendosja e shenjës tek mallrat ose ambalazhet e tyre; b) hedhja e mallrave në treg, ofrimi i tyre për shitje, duke përdorur këtë shenjë, ose krijimi dhe mbajtja e rezervave për këto qëllime; c) ofrimi i shërbimeve, duke përdorur këtë shenjë; ç) importimi ose eksportimi i mallrave, duke përdorur këtë shenjë; d) përdorimi i shenjës në veprimtarinë tregtare, në reklamime ose publicitete.

Për sa më sipër, neni 184 (2) i ligjit 9947 parashikon se përbën shkelje të të drejtës çdo përdorim, kufizim, imitim ose bashkëshoqërim i paautorizuar i markës tregtare, si dhe çdo veprim tjetër që çënon të drejtat e pronarit të saj.

Në këtë kontekst, dhe në kuptim të neneve 184/a dhe 184/b të ligjit 9947, pronari i një marke të regjistruar gëzon të drejtën për të ngritur padi për shkelje të të drejtave duke kërkuar: ndalimin e mallrave/shërbimeve që shkelin të drejtat e pronarit të markës së regjistruar; heqjen ose bllokimin nga qarkullimi civil të materialeve, pajisjeve, instrumenteve dhe mjeteve të përdorura kryesisht për krijimin ose prodhimin e mallrave ose shërbimeve që shkelin të drejtat;

në lidhje me mallrat e paligjshme (të falsifikuara), thjesht heqja ose shpëputja e markës së

ngjitur në këto mallra nuk është e mjaftueshme;  
publikimin e vendimit përfundimtar të gjykatës në median publike me shpenzimet e personit që ka kryer shkeljen, sipas mënyrës së parashikuar nga gjykata.  
Gjithashtu, Kodi Civil [neni 638] parashikon dhe sanksionon veprimet e konkurrencës së pandershme si veprime të kundërligjshme që kryhen prej cilitdo që:  
përdor emrat ose shënjat dalluese të cilat mund të sjellin ngatërresë me emrat dhe shënjat dalluese të përdorura ligjërisht nga të tjerë, ose imiton produktet e një konkurrenti ose kryen veprime të cilat mund të sjellin ngatërresa me produktet dhe veprimtarinë e një konkurrenti; trajton si të vetat cilësitë e produkteve ose të ndërmarrjes së konkurrentit;  
përdor vetë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi çdo mjet tjetër që nuk përputhet me parimet e ndershmërisë profesionale dhe mund të dëmtojë veprimtarinë e tjetrit.

Për sa më sipër, si dhe bazuar në situatën faktike dhe ligjore të demonstruar në këtë gjykim, konkludojmë se përdorimi në çfarëdo mënyre apo forme i markës “\*\*\*\*” apo “\*\*\*\*” pa autorizimin apo licensën përkatëse, përbën shkelje të drejtpërdrejtë të të drejtave të pronësisë industriale të Paditësit.

Në këtë drejtim, përdorimi i markës “\*\*\*\*” dhe ofrimi i shërbimeve online (nëpërmjet faqeve të ndryshme të rrjeteve sociale) nën këtë markë apo përdorimi i markës “\*\*\*\*”, nga ana e palës së paditur përbën jo vetëm shkelje të të drejtave të markës, por konsiston njëherazi në një veprim flagrant të konkurrencës së pandershme.

I padituri është i pozicionuar në treg si konkurrent paletës, ai shet/ofron mallra/shërbime identike nën një logo që klientet mund ta perceptojnë si një zgjatim të \*\*\*. E gjitha kjo rezulton në një konfuzion në treg, si bashkelidhje midis markave, si dhe në marrjen e përfitimeve nga reputacioni i markave të paditësit.

I padituri, duke ofruar shërbimet e tij online nën emrin “\*\*\* \*\* Albania”/”\*\*\* \*\*\*\*” dhe markën “\*\*\*\*” apo “\*\*\*\*”, krijon përshtypje tek konsumatorët se shoqëria “\*\*\*\*” vazhdon ende të jetë e lidhur ekonomikisht ose në çfarëdo formë tjetër me shoqërinë “\*\*\*\*”, ç’ka siç dhe u provua në gjykim, nuk është absolutisht e vërtetë.

Natyrisht, në rast se i padituri nuk do të dëshironte të shkelte të drejtat e pronësisë industriale të paditësit dhe të mos kryente veprime të tilla të përsëritura të konkurrencës së pandershme, atëherë ai nuk do të përdorte emrin “\*\*\* \*\* Albania”, markën “\*\*\*\*” apo markën “\*\*\*\*”. Në një rast të tillë, si dhe në përputhje me praktikën e ndershme të biznesit, i padituri do t’i ofronte shërbimet e tij online nën emrin “\*\*\*\*” dhe jo si “\*\*\* \*\* ALBANIA”.

Në këto kushte, si dhe bazuar në provat dhe faktet/rrethanat e reja të çështjes në fjalë, duke u ndalur veçanërisht në veprimet e ndërmarra në mënyrë të përsëritur nga i padituri në kundërshtim të hapur me ligjin dhe vetë pranimin e bërë në deklaratën e tij të mbrojtjes, gjykata çmon se pala e paditur duhet të pushojë këto çmime dhe të mos e perserise me ne të ardhmen, sipas disponimeve të bëra në dispozitivin e vendimit.

Nga ana tjetër referuar Nenit 106 të K. Pr. Civile gjykata çmon se shpenzimet gjyqesore, taksa e padisë 1% e vlerës së detyrimit si dhe shpenzimet e perfaqësuesit të palës paditëse që sipas faturave tatimore Nr. \*\*\* dt. \*\*\*\*ne shumen \*\*\* lek e paraqitur në konkluzionet përfundimtare, janë në ngarkim të palës së paditur.

Për sa më sipër u analizua gjykata çmon se kërkesë-padia është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet pranuar.

PER KETO ARSYE :

Gjykata bazuar në Nenin 126, 306 e vijues, 444 të K. Pr. Civile,

VENDOSI :

Pranimin e kerkese-padise.

Pushimi i cënimit të të drejtave të pronësisë industriale të shoqërisë “\*\*\*\*” që rrjedhin nga zotërimi i markës së regjistruar dhe të mirënjohur “\*\*\*\*”.

Ndalimin e të Paditurit që të përdorë markën tregtare “\*\*\*\*” dhe çdo shenjë tjetër të ngjashme me të, gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare, pa autorizimin e shoqërisë “\*\*\*\*”, duke përfshirë këtu edhe ndalimin e të Paditurit për të përdorur markën për qëllime marketingu, reklamimi ose publiciteti.

Ndalimi i të Paditurit të ofrojë shërbime duke përdorur markën “\*\*\*\*” dhe çdo shenjë tjetër të ngjashme me të.

Ndalimi i veprimeve të konkurrencës së pandershme nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe mospërsëritja e veprimeve të tilla në të ardhmen.

Publikimi i vendimit përfundimtar të gjykatës në median publike me shpenzimet e të Paditurit.

Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales se paditur.

Ky vendim eshte i ekzekutueshem nga permbaruesi gjyqesor.

Kunder ketij vendimi lejohet te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 15 diteve, afat ky qe fillon nga e nesermja e njoftimit te vendimit te arsyetuar paleve ndergjyqese.

U shpall sot me date 16. 02. 2021 ne Tirane.

SEKRETARE

GJYQTAR

LUSJANA FEZOLLARI

ERVIN POLLOZHANI